

VENDIM
Nr. 181, datë 13.4.2000

**PËR NJË SHITESË NË BUXHETIN E VITIT 2000, TË MINISTRISË SË TRANSPORTIT,
PËR RIVESHJEN PJESORE, NË RRUGËT TIRANË–NDROQ-PLEPA DHE VORË-DURRËS
ME PROCEDURËN E PROKURIMIT TË DREJTPËRDREJTË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 dhe 27, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 17, pika 3, të ligjit nr.7971, datë 26.7. 1995, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministrisë së Transportit , në planin e buxhetit të vitit 2000, në zërin “Investime”, i shtohen 92 milionë lekë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të cilat do të përdoren si vijon:

- 27 milionë lekë për riveshjen pjesore të segmentit rrugor Tiranë –Ndroq-Plepa;
- 65 milionë lekë për riveshjen pjesore të segmentit rrugor Vorë-Durrës.

2. Autorizohet Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të prokurojë fondin e mësipërm, me procedurën e prokurimit të drejtëpërdrejtë, me “Albavia”, sh.p.k.

3. Fondi prej 92 milionë lekësh të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Punimet në këto segmente rrugore të përfundojnë brenda 40 ditëve nga dita e lidhjes së kontratës.

5. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Transportit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta